



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(Në përfundim të afateve të ankimit)

21.11.2024

Drejtuar OE: MEKTRIN MOTORS, Nipt K51408501P, me adresë Autostrada Km.6 Xhafzotaj, Durrës.

Procedura e prokurimit/lotit: “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, mallra, kontratë.

Referenca e Lotit: Loti 4: REF-18801-09-11-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje automjete ndarë në 5 (pesë) lote”, Loti 4: “**Blerje Autoambulanca për Drejtorinë Përgjithshme të Burgjeve**”, me afat zbatimi brenda 3 (tre) muajve nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 60, datë 16 Shtator 2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “**C L A S S I C**” shpk, Numri i NIPT-t J91909004J
Vlera: 98,400,000 (nëntëdhjetë e tetë milion e katërqind mije) lekë pa TVSH.

2. “**MEKTRIN MOTORS**” shpk, Numri i NIPT-it K51408501P
Vlera: 106,350,000 (njëqind e gjashtë milion e treqind e pesëdhjetë mije) lekë pa TVSH.

3. BOE “**Albania Motor Company**” shpk & “**Autoelite**” shpk & “**TIMAC**” shpk,
Numri i NIPT-it: K41829010I & K67120001D & M01706003U
Vlera: 106,500,000 (njëqind e gjashtë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “**C L A S S I C**” shpk

Numri i NIPT-t J91909004J

Vlera: 98,400,000 (nëntëdhjetë e tetë milion e katërqind mije) lekë pa TVSH

Për arsye si më poshtë:

Operatori ekonomik me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST dhe konkretisht nuk plotëson pikën 1 të “Kapacitetit teknik” në lidhje me furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% (ose në vlerën 43,407,315.2 lek pa TVSH) e vlerës së fondit limit. Operatori ekonomik ka paraqitur punime të ngjashme brenda afatit 3 vjeçar nga data e zhvillimit të tenderit në shumen 36,432,343.65 leke pa tvsh. Për sa me lartë operatori ekonomik skualifikohet për paraqitje dokumentacioni të paplotë.

2. BOE “**Albania Motor Company**” shpk & “**Autoelite**” shpk & “**TIMAC**” shpk

Numri i NIPT-it K41829010I & K67120001D & M01706003U

Për arsye si më poshtë:

BOE “Albania Motor Company” shpk, me NUIS K41829010I + OE “Autoelite” shpk, me NUIS K67120001D dhe OE “TIMAC” me NUIS M01706003U, krijuar me Kontratën e Bashkëpunimit me nr. REP. 4641 dhe Nr. Kol 3228, datë 02.10.2024, me pjesëmarrje të shoqërive të shprehur në përqindje si më poshtë: “Albania Motor Company” sh.p.k në masën 51 % në këtë pjesëmarrje, “Autoelite” shpk në masën 9 % në këtë pjesëmarrje dhe “TIMAC” shpk në masën 40 % në këtë pjesëmarrje.

Me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

BOE me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST dhe konkretisht nuk plotëson pikën 1 të “Kapacitetit teknik” në lidhje me furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Pasi anëtari i bashkimit të përkohëshëm të operatoreve ekonomik “Autoelite” shpk nuk ka ngarkuar asnjë faturë/dokumentacion në lidhje me furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës edhe pse ka marrë persiper 9% të kontratës.

BOE me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST dhe konkretisht nuk plotëson pikën 4 të “Kapacitetit teknik” *“Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë: • ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent”* pasi nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të ngarkuar nga operatori ekonomik në sistemin e prokurimeve elektronike rezultoi se operatori ekonomik “Autoelite” shpk nuk ka paraqitur certifikatën **ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë”**.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: **MEKTRIN MOTORS** shpk, *Nipt K51408501P, me adresë Autostrada Km.6 Xhafzotaj, Durrës* se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **106,350,000** (njëqind e gjashtë milion e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve**, me adresë *Rruga "Zef Serembe", Tiranë* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda afatit që do t'iu njoftohet nga autoriteti kontraktor përfitues.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)

- Vendimi nr. 1354/24 datë 31.10.2024 i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.
- Vendimi nr.1545 datë 04.11.2024 i Komisionit të Prokurimit Publik (Vendim për mbylljen e çështjes)
- Vendimi nr.1623 datë 18.11.2024 i Komisionit të Prokurimit Publik (Lejimin e AK për vijimin me hapat e mëtejshëm)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR